REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 19/17 , 21/17
Datë/Datum. 10.02.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit: **Qendra Klinike Universitare e Kosoves**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - **OSHP Nr.19-21/17**
Nga:	Safije Saramati - Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Ekspertiza për lëndën **"Furnizim me material për shtyp", me nr prok 701/16/109/121**		
Përgjigjeje në ankesë:	**"NTG "Blendi "NTGI "Graf-Loni " me seli ne Prishtinë**		
Datë	**10.02.2017**		

Bazuar në nenin 113.1 të LPP-së ju njoftojmë me ekspertizën e lëndës lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me material për shtyp"** me nr. prokurimi: **(QKUK) 701/16/109/121"**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Qendra Klinike Universitare e Kosoves** , dhe me përgjigjeje ndaj ankesës së operatorit ekonomik: **NTG "Blendi" me seli ne Prishtinë & "Graf Loni" NTGI –me seli ne Prishtinë -"** me nr.prot.701/16/109/121, e datës 10.02.2017

Konform nenit 113.1, Pjesa IX e LPP-së, Eksperti Shqyrtues i pavarur, ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë, dhe ka konstatuar si më poshtë.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

1x1 Panelit Shqyrtues të OSHP-së.
1x1 Autoriteti Kontraktues.
1x1 Operatorit ekonomik ankues.

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

		30.01.2017		**31.01.2017**		**10.02.2017**
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të eksp.*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën 20.01.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. **19/17** e parashtruar nga **OE "NTG Blendi"** me seli në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me material për shtyp"**, me nr. të Prokurimit: AP : 701/16/109/121 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Qendra Klinike Universitare e Kosovës.**

Me datën 20.01.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. **21/17** e parashtruar nga **OE "NTGI Grafo-Loni,** me seli në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me material për shtyp"**, me nr. të Prokurimit: AP : 701/16/109/121,të iniciuar nga Autoriteti **Qendra Klinike Universitare e Kosovës.**

Kontraktues (AK) –Konform nenit 113 te Ligjit Nr. 04/L-042, Eksperti Shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – **Qendra Klinike Universitare e Kosovës.**

N.111,LPP - Operatori Ekonomik Ankues "NTG Blendi" **sh.p.k** me seli në Prishtinë

Pikat e Ankesës nga OE "NTG Blendi" - *dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:*

Neni 7 (Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi)

Neni 59 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve)

Neni 60 (Kriteret për Dhënien e Kontratës)

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Ne vijim i shfaqim agrumentet tone per tenderin ne fjale: "Furnizim me material për shtyp, të cilat Organi Shqyrtues i Prokurimit duhet ti kete perbaze.

Ne vijim i shfaqim pikat e ankesës nga kompania jonë, për shkeljet e Autoritetit Kontraktues- të udhëhequr nga Departamenti i Prokurimit, për tenderin "Furnizim me material për shtyp", duke e shpallur fitues tenderuesin "Office I Kosova" nga Prizreni edhe pse nuk i ka plotësuar kërkesat lidhur me aftësitë teknike dhe/ose profesionale, të cilat Organi Shqyrtues i Prokurimit duhet ti merr parasysh në shpjegimin dhe arsyetimin në vijim:

Autoritetit Kontraktues, ka shkelur nenin 7 i Ligjit të Prokurimit Publik - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, sepse duke e shpallur tenderuesin e papërgjegjshëm "Office 1 Kosova" fitues, na ka trajtuar të pabarabartë dhe na ka diskriminua me këtë veprim, sepse kompania "Blendi" ka ofruar tenderin e përgjegjshëm me çmimin me te ulët sipas radhitjes së ofertave nga Proces verbali i hapjes prej 68,150.00 €.

Kompania "Blendi" pas marrjes së njoftimit nga AK për tenderuesin e pasuksesshëm ka kërkuar qasje në dokumentacion për këtë tender dhe AK na ka mundësuar qasjen e duhur.

Me rastin e qasjes në dokumentacionin e tenderuesit fitues "Office i Kosova" kemi konstatuar se Autoritetit Kontraktues ka shkelur nenin 59 i Ligjit të Prokurimit Publik - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, dhe neni 41 i Rregullave dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik në Kosovë, ku Autoriteti Kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, por "Office 1 Kosova" nuk i ka plotësua të gjitha kërkesat.

"Office 1 Kosova" nga Prizreni, nuk ka dorëzuar dëshmi si është kërkuar në Dosjes së tenderit dhe në Njoftimit për kontratë (Kapaciteti teknik dhe profesional):

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional Kërkesa 1: Operatori ekonomik ofertues duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me

Sukses se paku tri kontrata te natyrës se njëjte përgjatë tri viteve te fundit 2013, 2014, 2015.

Dëshnia e kërkuar dokumentare Evidenca 1: Operatori Ekonomik ofertues duhet qe te ofroj një liste te kontratave, minimum 3 te realizuara gjatë 3 viteve të fundit: 2013.2014.2015, të përcjellura me referenca.

Gjatë kontrollimit të dokumentacionit të tenderuesit fitues "Office 1. Kosova", kemi gjetur të bashkangjitur vetëm një referencë nga Lista e furnizimeve kryesore, të realizuar gjatë 3 viteve të fundit: 2013.2014.2015, e cila është e natyrës së njëjtë dmth. për material shtypi, kurse të tjerat referenca janë furnizime me material zyrtar, e që nuk kanë të bëj me lemin e shtypit, kurse kërkesa ka qenë Operatori ekonomik ofertues duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses se paku tri kontrata te natyrës se njëjtë përgjatë tri viteve te fundit 2013, 2014, 2015, të gjitha këto dëshmi na i kanë mundësuar me rastin e qasjes në dokumente dhe i kemi të fotokopjuara.

Është shkelur neni 60 i Ligjit të Prokurimit Publik- Kriteret për Dhënien e Kontratës, përkatësisht Dosja e tenderit Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), Kriteret e Dhënies pika 31.1 Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar : tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

Këtu Autoriteti Kontraktues, nuk e ka respektuar kriterin e dhënë për të na shpallur neve fitues, sepse kemi dorëzuar tender të përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Pas këtyre argumenteve të prezantuara për parregullsitë dhe shkeljet e cekura nëpërmjet kësaj ankese, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, ta aprovoj ankesën tonë, të marr vendim mbi anulimin e njoftimit mbi dhënien e kontratës dhe aktiviteti i prokurimi për tenderin "Furnizim me material për shtyp", të kthehet në RIVLERESIM.

SS

N.111,LPP - Operatori Ekonomik Ankues "Ntgi Grafo-Loni " - me seli në Prishtinë

Pikat e Ankesës nga OE NSHT "Ntgi Grafo-Loni" - *dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:*

Sipas vlerësimit profesional të kompanisë "Grafo Loni" nga Prishtina, Qendra Klinike Universitare e Kosovës, për këtë tender (Furnizim me material për shtyp), ka bërë shkelje ligjore të dispozitave të Ligjit Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/-237, më tutje Ligji i Prokurimit Publik.

Shkelja e dispozitave Ligjore nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës - Departamenti i Prokurimit kanë të bëjnë ma sa vijon :

1. Është shkelur neni 6 i Ligjit të Prokurimit Publik (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti),
2. Është shkelur neni 7 i Ligjit të Prokurimit Publik (Barazia në Trajtim/Jo Diskriminimi),
3. Është shkelur neni 59 i Ligjit të Prokurimit Publik dhe neni 41-Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve),
4. Është shkelur neni 60 i Ligjit të Prokurimit Publik (Kriteret për Dhënien e Kontratës)

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Pikat e ankesës nga ana jonë si vijon :

1. Kompania e jonë mendon se me këtë rast është shkelur neni 6 i Ligjit të Prokurimit Publik (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti), sepse me këtë rast Qendra Klinike Universitare e Kosovës nuk ju ka përmbajt obligimit që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike dhe efikase, sepse me këtë rast kompania e shpallur fituese "Office 1 Kosova" nga Prishtina me çmim prej 64,030.00 € e që është është më i shtrenjtë për 21,040.50 €, për këtë shumë dëmtohet Buxheti i Republikës së Kosovës.

2. Është shkelur neni 7 i Ligjit të Prokurimit Publik (Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi), sepse Autoriteti Kontraktues- Qendra Klinike Universitare e Kosovës, me këtë rast na ka vu në pozitë të

pabarabartë dhe diskriminuese me këtë veprim, sepse kompania e jonë në këtë tender, ka ofruar çmimin me te ulët sipas radhitjes së ofertave nga Proces verbali i hapjes, kurse kontrata i është dhënë tenderuesit "Office 1. Kosova" nga **Prishtina me çmim më të lartë për 21,040.50 €.**

3. Është shkelur neni 59 i Ligjit të Prokurimit Publik dhe neni 41.8-Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve), ku Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, çka kompania "Grafo Loni" i ka plotësuar kërkesat e cekura dhe të kërkuara nga AK dhe po ju dërgojmë shpjegimin në Vijim.

Kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, që me kujdes edhe një herë ta shikoj rivlerësimin e bërë nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës, sepse nuk e ka bërë vlerësimin llogaritjen si duhet sepse Tenderi i dorëzuar nga "Grafo Loni" është I përgjegjshëm.

Qendra Klinike Universitare e Kosovës na ka njoftuar me datë 05.01.2017 me "Letër standard për tenderuesin e eliminuar", se jemi eliminuar për shkak kemi pasur gabime aritmetike më shumë se 2 %. Mirëpo me këtë rast e kemi kontrolluar edhe një herë tenderin- ofertën tonë (Grafo Loni) - Pjesa e II - LISTA E ÇMIMEVE dhe e kemi vërtetuar se pa dashje janë lëshuar gabime aritmetike në total, mirëpo ky gabim aritmetik nuk e kalon dy përqind (2%) të vlerës së ofertës.

Gjithsej oferta e "Grafo Lonit" është në hapje 43,699.50 €, kurse pas përmirësimit të gabimeve aritmetike oferta duhet të jetë 42,989.50 €, dallimi është 710,00 €, që dmth vetëm 1,62 % (710.00 x 100/43,699.50 = 1,62).

Me këtë rast Autoriteti Kontraktues - Qendra Klinike Universitare e Kosovës, duhet të veproj në pajtueshmëri me nenin 59 paragrafi 3 i Ligjit të Prokurimit Publik dhe neni 41. Pika 8-Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik,41.8AK do të përmirësojë gabimet plotësisht aritmetike në tender nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoft ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës.

i. Ne rast se shuma e korrigjuar është me pak se +/- 2%, AK do te përmirësoj gabimet e tilla dhe do te informoj me shkrim OE ne fjale duke përdorur formën standarde B49. Ne rast se OE ne fjale nuk pranon përmirësimin e gabimit, oferta ne fjale do te refuzohet. AK gjithashtu duhet ti dërgojë të gjithë tenderuesve përkatës (OE te cilët kane dorëzuar tender) një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla.

ii. Ne rast se shuma e korrigjuar është me shume se +/- 2%, AK do te eliminoj OE dhe do te informoj me shkrim OE ne fjale duke përdorur formën standarde B42.

4. Është shkelur neni 60 i Ligjit të Prokurimit Publik (Kriteret për Dhënien e Kontratës),

Kontrata do t'i jepet operatorit ekonomik që ka dorëzuar: Tenderin e përgjegjshëm, me çmimin më të ULËT; Këtu Autoriteti Kontraktues, nuk e ka respektuar kriterin e dhënë për të na shpallur neve fitues me çmim prej 42,989.50€, por kontrata i është dhënë tenderuesit "Office 1. Kosova" nga Prishtina me çmim më të lartë për shumën prej 64,030.00 €.

Pas këtyre argumenteve të prezantuara për parregullsitë dhe shkeljet e cekura nëpërmjet kësaj ankese, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, ta aprovoj ankesën tonë, të marr vendim mbi anulimin e njoftimit mbi dhënien e kontratës dhe aktiviteti i prokurimi për tenderin "Furnizim me material për shtyp", të kthehet në RIVLERESIM.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP :	16 .08.2016
Lloji i procedurës së aplikuar:	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:	Punë/vlerë e mesme
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë):	07.09.2016
Data e hapjes së ofertave	29.07.2016-14:30h
Kriter për dhënie të kontratës:	*Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët*
Lloji i kontratës:	*Kontratë kornize – 12 muaj*

Kriteret për vlerësim

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

Kërkesa 1: Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237 LPP mund të shkarkohet nga http://krpp.rks-gov.net.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Evidenca 1: Një deklarata e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2.

Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërise do të kërkohen nga tenderuesi të cilit QKUK ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të QKUK, për synimin e dhënies së kontratës. Dështimi për të paraqitur një nga këto dokumente brenda afatit kohor të përmendur, do të thotë që tenderuesi do të refuzohet, do ti konfiskohet garancioni i sigurimit te ofertës dhe QKUK do të vazhdojë me tenderuesin e radhës në rang-listë.

Dokumentet te cilat do te kërkohen si dëshmi për përmbushje te kërkesave te pranueshmërise janë me se vijon:

a. Për situatën referuar pikës 6.2 [a,b,c,d, e dhe f] dhe pikës 6.3 [a,b dhe d], vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit. **(origjinali ose kopja e noterizuar)**

Për situatën referuar pikës 6.3 [h (tatimit)], vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit *[para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës]*. **(kopje).**

S.S

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

Kërkesa 1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit.

Kërkesa 2. Regjistrimi i Numrit Fiskal për kompanitë vendore.

Kërkesa 3. Certifikata e TVSH-së.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Evidenca 1. Certifikata e regjistrimit te biznesit – kopje.

Evidenca 2. Certifikata e numrit fiskal – kopje.

Evidenca 3. Certifikata e TVSH-së kopje.

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar

Kërkesa 1: Operatori ekonomik ofertues duhet të ofrojë dëshmi se ka qarkullim nëpërmes bankës minimum 200,000.00 € (Dyqind Mijë Euro) ne 3 vitet e fundit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Evidenca 1: Operatori Ekonomik ofertues duhet që të dëshmoj me vërtetim të lëshuar nga banka se gjatë 3 viteve të fundit: 2013,2014,2015, ka qarkullim minimum 200,000.00 € (Dyqind Mijë Euro) .

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

Kërkesa 1: Operatori ekonomik ofertues duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses se paku tri kontrata te natyrës se njëjte përgjatë tri viteve te fundit 2013,2014,2015.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Evidenca 1: Operatori Ekonomik ofertues duhet qe te ofroj një liste te kontratave, minimum 3 te realizuara gjatë 3 viteve të fundit: 2013,2014,2015, të përcjellura me referenca.

S. S

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatoret ekonomik	Vendi	Çmimi total për njësi €	Vërejtje
1.	PRINTING PRRESS	PRISHTINË	49.672.20	
2.	EUROPRINTIY	FUSH KOSOV	77.831.00	
3.	DUKAGJINI	PEJË	99.959.216	
4.	BLENDI	PRISHTINË	68.150.00	
5.	GRAF LONI	PRISHTINË	43.699.50	
6.	NORA	PRISHTINË	36.408.80	
7	LITOGRAFIA	GJAKOVË	39.889.70	
8	OFFICE KOSOVA	PRIZREN	64.03.00	
9	BERATI	PRIZREN	42.715.65	
10	KGT	PRISHTINË	98.957.16	
11	AGIMI DE	DEQAN	38.746.30	
12	ARF SHPK	FUSH KOSOV	69.770.00	

5.5

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- Zenel Kuqi - Kryetar i komisionit
- Fisnik Thaqi - Anëtar i komisionit
- Kushtrim Namani - Anëtar i komisionit

Data e mbarimit të vlerësimit: 07.09.2016

Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....09.07.2016

Data e njoftimit të Dhënies së Kontratës në faqen e Krpp-së :.....03 .08.2016

Raporti i komisionit vlerësues:

Pas ekzaminimit, vlerësimit propozon për kontrat OE "Office 1 Kosoav "-Prizrën si të përgjëgjëm me qmim me te lire

J.S

Përgjigjet e ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimet ankimore të OE ankues:

Autoriteti Kontraktues gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, me vlerë të mesme, kontratë për furnizim, dhe kriter për dhënie të kontratës ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Sqarimi nr.1

Lidhur me pretendimin ankimor te operatorit ekonomik ''Graf loni'' se AK- QKUK nuk ka bërë vlerësimin e ofertave sipas nenit 59 të LPP-së si dhe nenin 41 pika 8 e Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ, ekspertja shqyrtuese sqaron se edhe pas permisimit që ka bërë operatori ekonomik ankues ku nga 43.699.50, ne permisim ka rezultuar të jetë 42.989.5 ku diferenca qëndron 710, dhe sipas kalkulimit shuma është brenda 2% dhe nuk e kalon shumën prej 2%. Ekspertja shqyrtuese sqaron se është i qëndrushem pretendimi i OE ankues "Grafi Lon" pasiqë sipas nenit 41. 8 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ [*AK do të përmirësojë gabimet plotësisht aritmetike në tender nëse gabimet e tillanëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmisim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind (2%) të vlerës totale të ofertës.*

i. Ne rast se shuma e korrigjuar është me pak se +/- 2%, AK do te përmirësoj gabimet e tilla dhe do te informoj me shkrim OE ne fjale duke përdorur formën standarde B49.
Ne rast se OE ne fjale nuk pranon përmirësimin e gabimit, oferta ne fjale do te refuzohet.
AK gjithashtu duhet ti dërgojë të gjithë tenderuesve përkatës (OE te cilët kane dorëzuar tender) një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla.

ii. Ne rast se shuma e korrigjuar është me shume se +/- 2%, AK do te eliminoj OE dhe do te informoj me shkrim OE ne fjale duke përdorur formën standarde B42].

Sqarimi nr.2

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Grafi Lon" se AK- QKUK me rastin e vlerësimit të ofertave nuk ka respektuar nenin 60 të LPP-së dhe ka rekomanduar për kontratë OE me cmim më të lartë, ekspertja shqyrtuese sqaron se ky pretendim ankimor është i qëndrueshëm pasiqë OE ankues "Grafi Lon" ka ofertuar me cmim prej 43, 699. 50 ndërsa Oe i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me cmim prej 64, 030. 00.

Sqarimi nr.3

Lidhur me pretendimin ankimor te operatorit ekonomik ankues "Blendi" NTG Prishtinë- se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit - ***III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional***
Kërkesa 1: *Operatori ekonomik ofertues duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses se paku tri kontrata te natyrës se njëjte përgjatë tri viteve te fundit 2013, 2014, 2015*

Eskepertja shqyrtuese sqaron se ky pretendim ankimor është i pjesërisht qëndrueshem, pasiqë kërkesë

J.S

e dosjes së tenderit ka qenë "tri kontrata të natyrës së njëjtë" ndërkaq Oe i rekomanduar për kontratë ka ofruar kontrata dhe referenca të natyrës së ngjashme sic është "Furnizim me material administrativ për nevojat e QKMF-së", "Furnizim me material harxhues për zyre", "Furnizim me material administrativ dhe furnizim me tonera", që janë kontrata të natyrës së ngjashme por jo të njëjtë sipas kërkesës së dosjes së tenderit.

Mendimi i ekspertit shqyrtues :

- Ekspertja shqyrtuese bazuar në konstatimet e cekura në ekspertizë mendon që **Autoriteti Kontraktues- Qendra Klinike Universitare e Kosoves**, për aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me material për shtyp"**, me nr. të prokurimit: AP : 701/16/109/121, nuk ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së, përkatësisht nenin 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i tenderit, si dhe nenin 60 të LPP-së- Kriteret për Dhënie të Kontratës. Poashtu ekspertja shqyrtuese sqaron se me rastin e rivlerësimit AK-QKUK nuk ka respektuar nenin 41. 8 e Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ, andaj ekspertja shqyrtuese i propozon panelit shqyrtues që aktivitetin e prokurimit ta kthejë në ri-vlerësim. Dhe të aprovohen si të bazuar ankesat e oe Aankues .

J.S